



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit "Biznesi" në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Fakultetit më 27. 01. 2012 miratoi këtë

RREGULLORE

MBI KODIN E ETIKES TË KOLEGJIT "BIZNESI"

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret që kanë të bëjnë me kodin e etikes dhe veprimit të Kolegjit "Biznesi".

1. Veprimi i Kolegjit "Biznesi" lidhur me rregullat e etikes .

1.1. Si pjesë e obligime ligjore dhe akademike Kolegji "Biznesi" ushtron veprimtarinë akademike në bazë të dispozitave ligjore pozitive në Kosovë dhe akteve të brendshme të Kolegjit "Biznesi".

1.2. Kolegji "Biznesi" do të respektojë të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë.

1.3. Kolegji "Biznesi" do t'i respektojë të gjitha parimet demokratike dhe standardet akademike që kanë të bëjnë me mësimdhënien universitare, sjelljen e mësimdhënësve, qendrimin e tyre ndaj studenteve dhe në procesin akademik në përgjithësi.

1.4. Kolegji "Biznesi" do t'i promovojë parimet pozitive të sjelljes së studenteve ndaj stafit akademik, duke respektuar rregullat akademike të përcaktuara me akte të brendshme të Kolegjit "Biznesi".

1.5. Kolegji do të promovojë vlerat pozitive në të gjitha raportet e komunikimit dhe të veprimit me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, stafin akademik dhe studentët.

1.6. E gjithë veprimtaria akademike shkencore-hulumtuese do të jetë në funksion të promovimit dhe avancimit të vlerave paqësore, akademike dhe shkencore hulumtuese për qëllime paqësore.

2. E gjithë veprimtaria akademike shkencore-hulumtuese (qofte punim kërkimor shkencor, punim diplome, punim magjistrature ose punim doktrate, veprimtari botuese, projekt hulumtues apo veprimtari tjetër akademike shkencore hulumtuese) duhet të jetë në pajtim me rregullat etike, metodologjinë hulumtuese, shkencore dhe akademike dhe jo plagjiaturë.

2.1. Është e ndaluar rreptësisht çdo formë dhe mënyrë e plagjiaturës akademike dhe shkencore hulumtuese, si nga stafi akademik po ashtu edhe nga studentët e Kolegjit "Biznesi".

2.2. E gjithë veprimtaria akademike shkencore-hulumtuese që vërtetohet se është plagjiaturë do të procedohet sipas rregullave ligjore të Kolegjit "Biznesi"

si dhe legjislacionin që ka të bëjë me Arsimin e Lartë në Kosovë dhe ndaj kryerësit të plagjiaturës (qoftë staf akademik apo studentë) do të merren masa konform dispozitave ligjore.

2.3 Komisioni për vlerësimin e temës së diplomës ,temës së magistraturës ,temës së doktorantit apo publikimeve shkencore pas vlerësimit të punimeve merr vendim për anulimin e punimeve në rastet kur konstaton plagjiaturë apo gabime të ndryshme metodologjike në rastet hulumtuese shkencore.

3. Të gjitha rregullat e mirësjelljes dhe të etikës akademike të përcaktuara me akte të Kolegji “Biznesi” dhe akte të tjera ligjore të aplikueshme sipas LMAK do të aplikohen ndaj stafit akademik, stafit administrativ dhe studenteve të Kolegji “Biznesi”.

3.1. Zbatimi i rregullave etike-morale nga ana e stafit akademik-mësimdhënësve, ndaj studentëve është një prej obligimeve themelore dhe të patjetërsueshme të Kolegji “Biznesi”.

3.2. Të gjitha raportet që kanë të bëjnë me kodin e etikës do të rregullohen mbi bazën e obligimeve dhe të rregullave dalin nga statuti dhe rregulloret e Kolegji “Biznesi”, si dhe nga aktet e tjera ligjore që kanë të bëjnë me LALK.

3.3 Të gjitha shkeljet e kësaj rregulloreje që ka të bëjë me kodin e etikës akademike do të procedohen sipas Rregullores mbi shkeljet disiplinore, si dhe akteve të tjera të Kolegji “Biznesi”.

3.4. Zbatimi i rregullave të kodit të etikës që ka të bëjë me studentët dhe stafit akademik do të jetë i bazuar konkretisht në aktet e brendshme të Kolegji “Biznesi”.

4. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan